

20141665156

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIN PËR MUNDËSI TË
BARABARTA TË FEMRAVE DHE MESHKUJVE**

Neni 1

Në Ligjin për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujve ("Gazeta Zyrtare e Republikën e Maqedonisë" numër 6/12) në nenin 6 pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

"(5) Ministri i Punës dhe Politikës Sociale në pajtim me ministrin e Arsimit dhe Shkencës e përcakton mënyrën e kryerjes së analizës nga paragrafi (4) i këtij neni."

Neni 2

Në nenin 8 pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

"(5) Ministri i Punës dhe Politikës Sociale i përcakton formën dhe përmbajtjen e raportit vjetor nga paragrafi (4) i këtij neni dhe mënyrën e zbatimit të planit për implementim nga paragrafi (3) i këtij neni."

Neni 3

Në nenin 11 pas paragrafit (9) shtohet paragraf i ri (10), si vijon:

"(10) Ministri i Punës dhe Politikës Sociale i përcakton formën dhe përmbajtjen e raportit nga paragrafi (8) i këtij neni."

Neni 4

Në nenin 14 paragrafi (7) pas fjalës "koordinator" shtohen fjalët: "dhe zëvendëskoordinator."

Neni 5

Në nenin 15 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"Ministri i Punës dhe Politikës Sociale i përcakton formën dhe përmbajtjen e raportit nga paragrafi (1) i këtij neni."

Neni 6

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujve.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".